

I nderuar z. Kadri Veseli,

Ju lutemi gjeni të bashkangjitur artikullin e fundit të botuar nga Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan, "(Pa) Barazia gjinore në politikë dhe vendimmarrje".

Me synim të fuqizimit të demokracisë, artikulli shqyrton pozitën e pafavorshme të grave në politikë dhe qeverisje të Kosovës. Artikulli identifikon aspektet të cilat e mirëmbajnë hendekun e madh të pabarazisë gjinore në Kosovë dhe ofron rekomandime konkrete për të përmirësuar barazinë gjinore në jetën politike dhe qeverisjen e vendit.

Bashkëndjenja me gjetjet e raportit është një gjë, ndërsa veprimi ndaj tyre është një gjë tjetër. Ju keni pozitën, fuqinë dhe mandatin të adresoni disa nga rekomandimet e listuara në këtë artikull. Pa intervenim serioz politik e insitucional kjo gjendje nuk do të ndryshoj.

Ne po i theksojmë fushat të cilat do të përfitonin nga reforma, në veçanti ato ku veprimet e juaja mund të adresojnë përfaqërimin dhe pjesëmarrjen e ulët të grave:

- Ligji për Barazi Gjinore duhet të monitorohet rregullisht për të siguruar zbatimin e tij. Sanksionet duhet të aplikohen dhe udhëzime të reja administrative duhet të miratohen.
- Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme duhet të ndryshohet për t'u harmonizuar me Ligjin për Barazi Gjinore.
- Gjuha diskriminuese dhe ofenduese duhet të ndalet. Rregullorja e Punës së Kuvendit duhet të përcaktojë qartë se çfarë nuk është e përshtatshme dhe çdo ministër duhet të ndërshkoj përdorimin e gjuhës degraduese. Sanksionet e qarta duhet të futen në Rregulloren e Punës.
- Përfaqësimi i grave në Qeveri duhet, së paku, të korrespondojë me nivelin e përfaqësimit në Kuvend.
- Delegacioni Shtetëror për Dialog me Serbinë duhet të rishqyrtohet që të përfshijë gra të kualifikuara. Përfaqësimi i grave të rregullohet brenda Projektligjit për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror.
- Promovimi i barazisë gjinore dhe kuotës brenda partisë tuaj politike, para zgjedhjeve të ardhshme.
- Bëhuni aleat i barazisë gjinore duke përdorur platformën dhe statusin tuaj për të promovuar nismat e grave dhe duke mbështur reformat që ndikojnë në të drejtat e tyre.

Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan, si një "think-tank" jo-partizan, është i angazhuar për të kontribuar në ndërtimin demokratik të shtetit dhe kohezionit të fortë social. Ne besojmë se institucionet po dështojnë në përmbushjen e mandatit të tyre për të përfaqësuar të gjithë qytetarët e Kosovës, andaj ju bëjmë thirrje t'u jepni përparësi reformave që mund ta rregullojnë këtë ç'ekuilibër.

Ju lusim të na kontaktoni në lidhje me çdo aspekt të artikullit, dhe për angazhimin e përbashkët që mund të kemi.

Me nderime,

Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan

